

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7043
E enjte, 9 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

KMDLNj-ja: Shqipëria për fundvit fal 570 të burgosur, Kosova asnjë!

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HASANI: ASOCIACIONI, JASHTË RENDIT KUSHTETUES TË KOSOVËS

FAQE 3




Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka theksuar se draft-statuti i ri i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është jashtë rendit kushtetues të

Kosovës. "Kjo çfarë po ndodh, edhe kjo bashkësi e komunave do të operojë jashtë rendit kushtetues të Kosovës. Do të thotë si mos të ekzistojë Kushtetuta e Kosovës

fare", ka thënë Hasani, duke shtuar se me anë të themelimit të Asociacionit, Serbia futet si asnjëherë më parë në çështje të brendshme të Kosovës

AKTUALE



I NXEHTI I TETORIT POTHUAJSE GARANTON SE VITI 2023 DO TË JETË MË I NXEHTI NË HISTORI F. 2

OSMANI TAKON PRESIDENTIN E SINGAPORIT, DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK F. 3

BISLIM BISLIMI EMËROHET SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MKRS-së F. 6

EKONOMI



TAKIMI I MINISTRAVE TË EVROPËS JUGLINDORE, KOSOVA: PËRPJEKJET TONA PËR BASHKËPUNIM NË BUJQËSI NUK DUHET TË PENGOHEN

F. 8

KEDS-I INVESTON RRETH 2 MILIONË EURO NË DEÇAN F. 8

SPORT



BALLKANI KËRKON 'HAKMARRJE' NDAJ ASTANËS F. 10

KE-JA MIRATON PAKETËN E ZGJERIMIT, THOTË SE RRUGA E KOSOVËS NDIKOHET NGA DIALOGU ME SERBINË F. 4



THEMELOHET INSTITUTI PËR ADRESIMIN E KRIMEVE TË KRYERA NGA SERBIA, ATDHE HETEMI EMËROHET DREJTOR F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Amnesty International e quan të paligjshme marrëveshjen në mes të Italisë dhe Shqipërisë për emigrantët

LONDËR, 8 NËNTOR - Amnesty International ka thënë se marrëveshja ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë për dërgimin e emigrantëve të shpëtuar në Detin Mesdhe në qendrat e ndalimit në Shqipëri është e "jashtëligjshme dhe e pazbatueshme".

Më 6 nëntor, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, nënshkruan një marrëveshje, sipas së cilës, Italia do t'i dërgojë në Shqipëri emigrantët që i kap dhe i shpëton në Detin Mesdhe, duke filluar nga pranvera e vitit të ardhshëm. Por, Elisa De Pieri, hulumtuuese rajonale në Amnesty International, tha se njerëzit që shpëtohen nga autoritetet italiane, përfshirë ata që kërkojnë siguri në Evropë, janë nën juridiksionin italian dhe për këtë arsye nuk mund të dërgohen në një vend tjetër para se kërkesat e tyre për azil dhe rrethanat

individuale të jenë shqyrtuar. "Ajo është e jashtëligjshme, e pazbatueshme dhe duhet të shfuqizohet", tha ajo.

Ajo e akuzoi Italinë se përmes kësaj marrëveshjeje po përpiqet ta shmangë ligjin ndërkombëtar dhe të Bashkimit Evropian "duke pretenduar se njerëzit e ndaluar do të mbesin nën juridiksionin italian".

Qeveria shqiptare njoftoi të martën se Italia ia ka ndarë tashmë 16.5 milionë euro si paradhënie për shpenzimet e mbajtjes së emigrantëve në kampe në territorin e saj në bazë të marrëveshjes.

Dy kryeministrat deklaruan se marrëveshja ka tre objektiva: "të luftojë trafikimin e paligjshëm, t'i parandalojë flukset e parregullta dhe t'i mirëpresë ata që kanë vërtet të drejtën e mbrojtjes."

Por, De Pieri tha se marrëveshja ka të bëjë me "kthimin" e emigrantëve, një praktikë e cila është e ndaluar nga ligji



ndërkombëtar dhe evropian dhe për të cilin Italia është dënua nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e njeriut në vitin 2012, për kthimin mbrapsht në det të emigrantëve dhe azilkërkuësve afrikanë.

Ajo paralajmëroi "pasoja të rënda" për njerëzit që kërkojnë

azil, duke shtuar se ata mund të mbahen gjatë në qendrat e ndalimit dhe mund të përballen me shkelje larg monitorimit nga autoritetet gjyqësore italiane. Kjo marrëveshje shkaktoi reagime të shumta në të dyja shtetet, kryesisht për shkak të mungesës së transparencës.

Amnesty International i bëri thirrje Qeverisë së Italisë t'i përmbushë detyrimet e veta nga ligji ndërkombëtar për moskthimin e emigrantëve, si dhe i bëri thirrje Komisionit Evropian të mos i lejojë vendet anëtare t'i shkelin të drejtat e azilkërkuësve.

I nxehti i tetorit pothuajse garanton se viti 2023 do të jetë më i nxehti në histori

BRUKSEL, 8 NËNTOR - Ky tetor ishte më i nxehti i regjistruar globalisht, 1.7 gradë më i nxehtë se mesatarja për muajin tetor para epokës industriale - si dhe muaji i pestë me radhë me një rekord të tillë, që nënkupton se është pothuajse e sigurt se viti 2023 do të jetë viti më i nxehtë i regjistruar në histori.

Tetori ishte 0.4 gradë më i nxehtë sesa rekordi paraprak për tetorin nga viti 2019, duke e habitur madje edhe Samantha Burgessin, zëvendës drejtoreshën e Shërbimit të Bashkimit Evropian për Ndryshime Klimatike, Copernicus. "Shkalla me të cilën po i thyejmë rekordet është tronditëse", tha Burgess.



Pas të nxehtit të muajve të fundit, është praktikisht e sigurt se viti 2023 do të regjistrohet si viti më i

nxehtë në histori, sipas Copernicus. Shkencëtarët i vëzhgojnë klimat e

ndryshme për ta kuptuar se si planeti ynë zhvillohet si pasojë e emetimeve të gazrave serë nga dora e njeriut. Një planet më i nxehtë nënkupton mot ekstrem më të shpeshtë, si thatësira të mëdha apo uragane që përmbajnë më shumë ujë, tha Peter Schosser, zëvendës president i Labororit për të Ardhme Globale në Universitetin e Shtetit të Arizonës. "Kjo është një shenjë e qartë se ne po shkojmë drejt një regjimi klimatik i cili do të ketë më shumë ndikim të njerëzit", tha Schosser.

Ky vit ka qenë tejet i nxehtë kryesisht për shkak se oqeanet janë duke u ngrohur, që

nënkupton se ato po punojnë më pak tani se në të kaluarën për t'iu kundërvënë ngrohjes globale. Historikisht, oqeani e ka thithur 90 % të të nxehtit tepriçë nga ndryshimi klimatik, tha Burgess. Kjo nënkupton, sipas Schosser, se bota duhet të përgatitet për rekorde të reja si pasojë e ngrohjes. Ai shtoi se planeti po e tejkalon tashmë 1.5 gradë të ngrohjes prej epokës para industriale dhe se planeti ende nuk e ka parë ndikimin e plotë të ngrohjes. Ai, Burgess dhe shkencëtarët e tjerë thonë se nevoja për të vepruar për t'i ndaluar emetimet që po e ngrohin planetin është urgjente tani.

Përrshpejtohet evakuimi nga Gaza pas rihapjes së pikëkalimit Rafah

GAZË, 8 NËNTOR - Numri i njerëzve që u larguan nga Rripi i Gazës përmes Egjiptit u rrit të martën, një ditë pasi pikëkalimi Rafah u rihap.

Së paku 500 njerëz, shumica të huaj apo shtetas me dyshetësi, kaluan përmes Rafahut, pikëkalimit të vetëm që nuk është në kufi me Izraelin, sipas burimeve të sigurisë egjiptiane, raporton "Associated Press".

Evakuimi përmes këtij pikëkalimi ishte pezulluar të shtunën dhe të

dielën, pasi një ambulancë që po shkonte drejt Rafahut u godit nga një sulm ajror izraelit.

Burimet e sigurisë egjiptiane thanë se Egjipti po e vazhdon trysnin për rritjen e ndihmave dhe karburantit, si dhe të sigurisë për ambulancat në Rripin e Gazës. Ministria e Jashtme e Jordanisë tha se 262 jordanezë u evakuuan të martën, nga 569 të tillë sa kishin ngecur në Gazë pas shpërthimit të luftimeve atje.

Kanadaja tha se 59 qytetarë të saj,

banorë të përhershëm dhe familjarë, u evakuuan.

Po ashtu, 19 banorë të Gazës që kishin nevojë për mjekim u lejuan ta kalojnë kufirin. Ata iu bashkuan dhjetëra të tjerëve që janë duke u mjekuar nëpër spitalet e Egjiptit. Vendet e tjera, shtetasit e të cilëve morën dritën jeshile për t'u larguar nga Gaza të martën ishin, Rumania, Gjermania, Moldavia, Ukraina, Filipinet dhe Franca, sipas autoriteteve kufitare të Gazës.



Hasani: Asociacioni, jashtë rendit kushtetues të Kosovës



Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka theksuar se draft-statuti i ri i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është jashtë rendit kushtetues të Kosovës. “Kjo çfarë po ndodh, edhe kjo bashkësi e komunave do të operojë jashtë rendit kushtetues të Kosovës. Do të thotë si mos të ekzistojë Kushtetuta e Kosovës fare”, ka thënë Hasani, duke shtuar se me anë të themelimit të Asociacionit, Serbia futet si asnjëherë më parë në çështje të brendshme të Kosovës

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka folur për draft-statutin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe të propozuar nga treshja evropiane. Ai ka theksuar se ky lloj i asociacionit nëse bëhet është jashtë rendit kushtetues të Kosovës. “Faktikisht kryeministri ka kompetenca shtesë, ia cakton Kushtetua, s’mund t’ia caktojë statuti që është akt nënligjor, mandej Gjykatës Kushtetuese i caktohen kompetenca. Faktikisht organet qendrore vihen në shërbim të bashkësisë së komunave serbe, shërbëtorë të tij”, ka thënë ai,

duke shtuar se: “Kjo çfarë po ndodh, edhe kjo bashkësi e komunave do të operojë jashtë rendit kushtetues të Kosovës. Do të thotë si mos të ekzistojë Kushtetuta e Kosovës fare”. Sipas Hasanit, draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk është ligj, pasi ligje nxjerr vetëm Kuvendi i Kosovës. Hasani draft-statutin e quajti “shkarravinë” dhe se, sipas tij, atë në Gjykatë Kushtetuese mund ta sjellë vetëm një kategori e personave që kanë rol publik në Kosovë. “Atë mund ta bien në gjykatë si vendim të qeverisë

vetëm deputetët, palët e autorizuara, Avokati i Popullit dhe presidentja e Kosovës. Nuk mundet kryeministri. Nuk pres prej Gjykatës Kushtetuese të shërbejë si bigë për proceset politike që janë pranuar me ndërkombëtarët”, ka deklaruar Hasani në “Klan Kosova”. Më tej, sipas Hasanit, me anë të themelimit të asociacionit, Serbia futet si asnjëherë më parë në çështje të brendshme të Kosovës dhe i kontestohet titulli juridik, pavarësia. “Serbia futet më shumë se asnjëherë më parë në çështjet e brendshme të Kosovës që lidhen me sovranitetin e brendshëm të Kosovës. Prej mënyrës së financimit. Neve na kontestohet titulli juridik i pavarësisë që është shpallur dhe që na ka pranuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Çdo zgjidhje e autonomisë serbe në Kosovë nuk mund të jetë e përhershme”, ka thënë Hasani. Emisari evropian Miroslav Lajçak ka përmblytur të martën vizitën dyditore në Kosovë, duke zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive opozitare dhe me ambasadorët e

akredituar në Kosovë, me të cilët ka biseduar për draft-statutin e ri të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesi i PDK-së dhe ai i LDK-së kërkuar të dinë më shumë hollësi rreth draft-statutit dhe u ankuan se po mbahen “në terr” për shkak të mosparaqitjes së dokumentit, ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, pretendoi se në takim opozitarëve u është paraqitur draft-statuti dhe e kanë lexuar në tërësi. I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, pas takimit me liderët opozitarë në Prishtinë, tha se kishte një ditë “shumë produktive në Kosovë me shkëmbime të mira për zhvillimet më të fundit në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe për rrugën përpara”. Lajçaku u takua një ditë më parë edhe zëvendëskryeministrin e parë, Besnik Bislimi, me të cilin tha në një postim në rrjetin social X, se u pajtua për hapat e ardhshëm dhe për zbatimin e plotë dhe pa vonesa e parakushte të marrëveshjes për

normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa Bislimi tha pas takimit se Kosova është e përkushtuar për normalizim të plotë të marrëdhënieve me Serbinë dhe për njohje reciproke. Lajçaku erdhi në Prishtinë rreth dhjetë ditë pas takimeve të fundit në Bruksel më 26 tetor, ku Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u takuan ndaras me liderët e Gjermanisë, Francës dhe Italisë si dhe zyrtarë të tjerë të BE-së. Para atyre takimeve, pesë emisarët perëndimorë në krye me Lajçakun vizituan Prishtinën dhe Beogradin më 21 tetor, ku ua prezantuan Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për Asociacionin, për të cilin thonë se është model modern evropian, por përmbajtja e të cilit nuk është bërë publike deri më sot. Kurti ka thënë se është i gatshëm ta pranojë dhe ta nënshkruajë draft-statutin për themelimin e Asociacionit, ndërsa presidenti serb Vuçiq e ka bërë të qartë se nuk do të pranojë asgjë që nënkupton njohjen de fakto të Kosovës.

Osmani takon presidentin e Singaporit, diskutojnë për bashkëpunimin ekonomik

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Presidentja Vjosa Osmani ka takuar presidentin e Singaporit, Tharman Shanmugaratnam, të cilin e ka uruar për marrjen e detyrës, njëkohësisht kanë pasur një diskutim përmbajtësor për thellimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, sidomos në fushën e bashkëpunimit ekonomik. Ajo e ka falënderuar presidentin e Singaporit për pritjen e ngrohtë. Në kuadër të vizitës së saj, fjalimi i presidentes Vjosa Osmani në Bloomberg New

Economy Forum në Singapor, është një ndër forumet më të mëdha dhe më të rëndësishme botërore në fushën e ekonomisë. Presidentja Osmani ka qenë pjesë edhe e një takimi të përbashkët të bizneseve nga Kosova e Singapori, duke e vlerësuar këtë takim një hap premtues për rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy shteteve. “Ishte angazhim që e morëm bashkë me palën singaporiane në qershor të vitit 2022 dhe e

realizuar këtë javë bashkë me kompani të suksesshme kosovare e kompani nga Singapori”, ka theksuar Osmani, duke shtuar se Singapori, dikur një ekonomi e papërfillshme, është shndërruar në pak dekada në një ndër vendet më të zhvilluara në botë falë njerëzve punëtorë, vendimeve të mençura e strategjike, luftimit të korrupsionit, investimit në arsim dhe shndërrimit në kryeqendër për investime të huaja.





KE-ja miraton paketën e zgjerimit, thotë se rruga e Kosovës ndikohet nga dialogu me Serbinë

Zyrtarët evropianë thanë të mërkurën se dialogu me Serbinë është rruga përpara për Kosovën drejt BE-së. Në konferencën për medie në Bruksel, presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, ka theksuar se zbatimi i Asociacionit me Shumicë Serbe mund të jetë një hap i madh përpara për Kosovën

BRUKSEL, 8 NËNTOR - Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave të pranimit në BE me Ukrainën, ndërsa rekomandoi hapjen e bisedimeve me Moldavinë pasi t'i përmbushë kushtet përfundimtare. Për Gjeorgjinë, shtoi KE-ja në një deklaratë më 8 nëntor, iu rekomandua dhënia e statusit zyrtar të kandidatit nëse i plotëson kushtet e mbetura të përcaktuara nga blloku. Në takimin e kolegjit të 27 komisionarëve evropianë të mërkurën, më 8 nëntor, u miratua paketa e zgjerimit, së bashku me raportet individuale të progresit për të gjitha shtetet e përfshira në këtë proces. Komisioni Evropian rekomandoi edhe hapjen e negociatave të anëtarësimit të Bosnjë-Hercegovinës me BE-në, kur të arrihet shkalla e nevojshme e pajtueshmërisë me kriteret për

anëtarësim. Komisioni do t'i raportojë Këshillit deri në mars 2024 për çdo progres. Përpjekjet për të arritur pajtim që edhe për Bosnjë-Hercegovinën të rekomandohet nisja e negociatave kishin hasur në kundërshtime gjatë takimit të shëfave të kabineteve të zhvilluar të martën. Në këtë takim zakonisht dakordohet për tekstin final, para se ai të miratohet, raporton "Radio Evropa e Lirë". Kosova mbetet i vetmi vend që nuk ka rekomandim për statusin e kandidatit nga këto dhjetë vende. Zyrtarët evropianë thanë të mërkurën se dialogu me Serbinë është rruga përpara për Kosovën drejt BE-së. Në konferencën për medie në Bruksel, presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, tha se zbatimi i Asociacionit me Shumicë Serbe mund të jetë një

hap i madh përpara për Kosovën. "Mendoj se është e rëndësishme që Kosova të ketë një qëllim shumë të qartë lidhur me anëtarësimin në BE, që ne të jemi të qartë se çfarë presim nga Kosova. Ne diskutuam, kur isha në rajon, për zbatimin e draft-statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, dhe ky zbatim do të ishte një hap i madh përpara. Është në interes të Kosovës", tha ajo. Edhe pse Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE, komisionari për Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, tha se Këshilli ende nuk ka kërkuar nga komisioni që të japë opinion për këtë. "Ne jemi të gatshëm ta japim opinionin", tha ai. "Ndjenja jonë është se për Kosovën rruga drejt BE-së po vjen përmes një dialogu të suksesshëm. Ata duhet t'i dyfishojnë përpjekjet e tyre për ta bërë dialogun të suksesshëm",

shtoi Varhelyi.

Për herë të parë raportet e progresit u miratuan për dhjetë shtete që janë në këtë proces. Raportet u miratuan për gjashtë shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor - Kosova, Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe për Moldavinë, Gjeorgjinë e Ukrainën. Po ashtu, Raport Progresi ende hartohet edhe për Turqinë, shtet që formalisht ende ka statusin e vendit kandidat. Në procesin e zgjerimit, Komisioni Evropian bën vlerësime dhe jep rekomandime, ndërkaq vendimet formale miratohen në Këshillin Evropian nga liderët e vendeve anëtare që vendosin me unanimitet. Rekomandimet dhe raportet e miratuara më 8 nëntor në Komisionin Evropian do të jenë në rend dite në takimin e radhës të Këshillit Evropian që do të mbahet në dhjetor. Sa iu përket raporteve të progresit për shtetet e Ballkanit Perëndimor, "Radio Evropa e Lirë" më 7 nëntor publikoi përmbajtjen e disa drafteve në të cilët ka pasur qasje.

Në Raportin e Progresit për Kosovën, në shumicën e fushave që vlerësohen, Komisioni Evropian ka thënë se Kosova ka shënuar "përparim të kufizuar". Në raport gjerësisht përmendet edhe situata e tensionuar e sigurisë në veri të Kosovës që banohet me shumicë serbe, por edhe për procesin e normalizimit të raporteve me Serbinë përmes dialogut që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Në raportin për Kosovën shprehjet keqardhje që Kosova dhe Serbia nuk kanë nisur t'i kryejnë obligimet e tyre nga dialogu pa parakushte dhe vonesa të tjera. Kosovës i bëhet ftesë veçmas që të themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Në raport tashmë kërkohet që Asociacioni të themelohet duke pasur për bazë propozimin e fundit për draft-statusin për Asociacionin, që u është prezantuar palëve më 21 tetor. "Nga Kosova pritet që të nisë procesin i cili çon deri te themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe bazuar në propozimin evropian që u është paraqitur palëve më

Themelohet Instituti për Adresimin e Krimeve të Kryera nga Serbia, Atdhe Hetemi emërohet drejtor

Kryeministri Albin Kurti ka emëruar Atdhe Hetemin drejtor ekzekutiv të Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë. Duke i uruar sukses në detyrën e re, Kurti ritheksoi se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për të vërtetën, të drejtën për të ditur dhe drejtësinë, si dhe për ballafaqimin me të shkuarën si kusht për një të ardhme të ndritur. Ai ritheksoi angazhimin e vazhdueshëm institucional për adresimin e të gjitha krimeve të kryera nga Serbia gjatë luftës në Kosovë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 8 nëntor - Kryeministri Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të mërkurën, ka bërë me dije se janë duke jetësuar Institutin që do t'i adresojë krimet e Serbisë në luftën e viteve 1998-1999. "Sot emërova z. Atdhe Hetemi drejtor ekzekutiv i Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, që do t'i prijë këtij procesi të rëndësishëm. Atdhe Hetemi është ligjërues në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës. Ai ka përfunduar doktoraturën në Universitetin e Gentit në Belgjikë, me fokus në historinë politike të Ballkanit Perëndimor. Ka më shumë se pesëmbëdhjetë vjet përvojë profesionale, të përqendruar kryesisht në punë hulumtuese dhe hartim të politikave", ka thënë Kurti para kabinetit qeveritar.

Ai ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për të vërtetën, të drejtën për të ditur dhe drejtësinë, si parakusht për paqen e qëndrueshme. "Vazhdon angazhimi ynë institucional për adresimin e të gjitha krimeve të kryera gjatë luftës. Angazhimi ynë për t'i matur dëmet e shkaktuara. Andaj sot u bë edhe një hap në këtë drejtim, për institucionalizimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kujtesës kolektive, e cila do të na shërbejë edhe neve edhe brezave pas nesh", është shprehur ai.

Kryeministri ka thënë se krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi nuk janë të shkuara. "Sakrificat e popullit tonë është e madhe, plagët e luftës janë të thella dhe ende të pranishme. Është e pafund dhimbja. Duke i dokumentuar krimet e dëmet e luftës, ne edhe e ndajmë dhembjen, edhe e bëjmë më gjerësisht të njohur historinë



tragjike të shqiptarëve të Kosovës në raport me Serbinë kriminale. Kjo vlen për ta ruajtur historinë dhe për ta kujtuar të shkuarën. Përtej së qeni një çështje me rëndësi historike, adresimi i krimeve të kryera dhe dëmeve të shkaktuara është një obligim moral. Është dëshmi e përkushtimit të Republikës sonë ndaj vlerave të paqes dhe të drejtave të njeriut. Është detyrë e secilit prej nesh, për lirinë e paqen që e gëzojmë, që gjithmonë të kujtojmë sakrificën e popullit tonë", ka deklaruar Kurti,

duke theksuar se plagët janë ende të njoma. "Ato janë të hapura për mijëra familjarë të mbi 1600 personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës. Po i japim prioritet ndriçimit të fatit dhe vendndodhjes së të zhdukurve. Gjatë këtij viti në territorin e Republikës së Kosovës janë kryer gërmime vlerësuese në 11 lokacione. Prej tyre, pesë lokacione kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen e të paktën 6 viktimave të luftës, duke mos përfshirë gjetjet e fundit në Bishtazhin, Gjakovë dhe në Prizren. Aktualisht jemi në pritje të rezultateve të ADN-së", është shprehur ai.

Kurti ka thënë se sfida kryesore për zbardhjen e rasteve mbetet mungesa e informatave të besueshme dhe refuzimi për bashkëpunim nga ana e Serbisë, që vazhdon të qëndrojë mbi varreza masive teksa i mohon ato. "Si qeveri, kujdesemi maksimalisht për trashëgiminë e luftës në Kosovës. Kemi themeluar Komisionin Shtetëror për Hulumtimin dhe Dokumentimin e Trashëgimisë Kulturore të shkatërruar gjatë luftës së viteve 1998-1999. Kemi filluar projektin për memorializimin e fëmijëve të vrarë, të zhdukur apo që e kanë humbur jetën nga kushtet e luftës. Po hartojmë Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale, me

pjesëmarrje dhe kontribut edhe nga grupet e viktimave. Në përgjigje të pandëshkueshmërisë së krimeve të luftës në Kosovë, kemi hequr pengesat ligjore për gjykimin në mungesë të kriminelëve të luftës. Me ndryshimet që kemi bërë në legjislacionin përkatës, institucionet tona të drejtësisë mund t'i ndjekin dhe t'i dënojnë kryerësit e krimeve të luftës në mungesë, kudo që ata janë", ka theksuar Kurti.

Për t'i rritur kapacitetet për t'i trajtuar krimet e luftës, kryeministri ka bërë me dije se kanë shtuar buxhetin për pozita të reja në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. "Ndërsa në Policinë e Kosovës, nga një sektor, kemi ngritur Drejtorinë e Hetimit të Krimeve të Luftës dhe kemi dyfishuar numrin e hetuesve të krimeve të luftës. Kriminelët e luftës duhen nxjerrë para drejtësisë. Serbia duhet mbajtur përgjegjëse për krimet e kryera në Kosovë. Ato nuk parashkruhen. Andaj nuk mund të ketë amnisti për krimet e kryera nga okupatori e agresori serb gjatë luftës në Kosovë. Duke ruajtur kujtesën tonë kolektive për të kaluarën, ne edhe i mirëmbajmë lidhjet mes brezave edhe e kultivojmë traditën tonë të fisme të humanitetit", ka thënë kryeministri Albin Kurti.



21 tetor 2023. Nga Serbia kërkon që të mbështesë këtë proces dhe paralelisht ta nisë përmbushjen e obligimeve të saj kyçe nga Marrëveshja [drejt normalizimit të raporteve]", thuhet në tekst, ku shtohet se "formalitetet, përfshirë edhe ato që lidhen me miratimin, nuk duhet të jenë pengesa në rrugën e përparimit në zbatim".

Marrëveshja drejt normalizimit, që u arrit më herët gjatë vitit, kërkon nga palët të zhvillojnë marrëdhënie normale të fqinjësisë së mirë, t'ia njohin njëra-tjetrës dokumentet relevante dhe simbolet kombëtare. Për Kosovën,

marrëveshja nënkupton njohje de facto nga Serbia, ndërsa për këtë të fundit aneksi i saj parasheh që Kosova ta formojë një Asociacion të Komunave me Shumicë Serbe.

Ndërkaq, draft-statuti i prezantuar më 21 tetor nga përfaqësuesit e BE-së, Shteteve të Bashkuara, Italia, Gjermania dhe Franca, është thënë se është një model modern evropian. Ky dokument nuk është bërë publik, por kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se e ka pranuar atë dhe se i njëjti është shkruar me kujdes ndaj Kushtetutës së Kosovës.

Në raportin për Kosovën, po

ashtu, përmendet largimi i serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar dhe bojkoti i tyre në zgjedhjet lokale të prillit të këtij viti. Këto veprime cilësohen si "shkelje të obligimeve të Serbisë që dalin nga dialogu dhe paraqesin kthim prapa të Serbisë në përmbushjen e obligimeve të marra nga marrëveshja e parë për parimet për normalizimin e raporteve [e vitit 2013] dhe paraqet shkelje direkte të marrëveshjes për drejtësinë të vitit 2015". "Nga Serbia kërkohet që t'i inkurajojë serbët e Kosovës që menjëherë të kthehen në institucione, ndërkaq nga

Kosova që ta bëjë këtë të mundur. Që nga nëntori i vitit 2022 asnjëra palë nuk ka bërë asnjë hap në këtë drejtim", thuhet në raport.

Pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës në fund të majit, për shkak të kundërshtimit të serbëve për kryetarët e rinj shqiptarë të komunave, Kosova ka hartuar një legjislacion që u mundëson qytetarëve që përmes një peticioni t'i ndryshojnë kryetarët e komunave.

Situata në veri të Kosovës u përkeqësua edhe më shumë më 24 shtator, pas sulmit ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i serbëve të armatosur.

Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoiqi, ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon çdo përfshirje.

Pas miratimit në kolegjin e komisionarëve, paketën e zgjerimit do ta paraqesë para gazetarëve presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ndërsa para deputetëve të Parlamentit Evropian, komisionari për Zgjerim dhe Fqinjësi, Oliver Varhelyi.

Bislim Bislimi emërohet sekretar i përgjithshëm i MKRS-së

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Bislim Bislimi është emëruar sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, në mbledhjen e qeverisë të mërkurës, ka propozuar

emërimin e Bislimit, i cili është votuar unanimisht nga ministrat.

Shtatë persona të tjerë kishin synuar të njëjtën pozitë, ndërsa kundërkandidat kryesor i Bislimit ishte Arian Ahmeti. "Për pozitën sekretar i përgjithshëm kanë aplikuar

8 kandidatë, ndërsa 3 prej tyre kanë hyrë në listë të ngushtë, pasi i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me konkurs. Pas vlerësimit profesional nga komisioni shtetëror i pranimit përmes testit me shkrim dhe intervistës, kandidatët fitues që janë

vlerësuar mbi pragun 70 për qind të pikëve janë Bislim Bislimi dhe Arian Ahmeti. Në pajtim me dispozitat ligjore dhe pas përzgjedhjes nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, propozojmë emërimin e z. Bislim Bislimi për pozitën sekretar i



përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për një mandat katërvjeçar", ka thënë Gashani.

KMDLNj-ja: Shqipëria për fundvit fal 570 të burgosur, Kosova asnjë!

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se Shqipëria për fundvit ka falur 570 të burgosur, Kosova asnjë. "Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë përmes një ligji mori vendim që në fund të vitit 2023 të falë 570 të burgosur dhe të dënuar e që është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe me të drejtat e personave të privuar nga liria. Përfituesit e kësaj faljeje janë të kategorizuar sipas peshës së veprës, dënimit, moshës, gjendjes shëndetësore, gjinisë dhe shkallës së risocializimit etj. Kjo nuk është falja e parë që bëhet në Shqipëri por se është shndërruar thuaja në rregull. Në Kosovë, që nga përfundimi i luftës nuk ka pasur falje të personave të privuar nga liria në



mungesë të bazës ligjore për këtë. Të burgosurit kanë mundur të kërkojnë falje vetëm nga presidenti dhe nga Paneli për Lirim me Kusht. Këto adresa janë edhe sot në kohën kur falja nga presidentja është thuaja inekzistente ndërsa Paneli për Lirim me Kusht kohëve të fundit po sillet më dorëlibër ndonjëse, as

përsëafërmi me atë sa e meritojnë personat e privuar nga liria", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj ka theksuar se në vazhdimësi ka kërkuar që të votohet Ligji për Amnisti, por se nuk janë ndërmarrë veprimet, përjashtuar premtimet, kryesisht për qëllime politike.

"Ministria e Drejtësisë në Kosovë nuk ka mundësi apo përgjegjësi ligjore të falë të burgosurit në asnjë rast por as që ka treguar ndonjë gatishmëri të angazhohet më seriozisht në këtë drejtim, as kjo që është tani në qeveri e as ato para saj. Të privuarit nga liria që trajtohen në institucionet mbajtëse dhe korrektuese të Kosovës, në rrethana normale pasi t'i kenë kryer 2/3 e dënimit i drejtohen Panelit për Lirim me Kusht i cili merr vendim për lirim të menjëhershëm nëse vlerëson se i kanë plotësuar kushtet e që pastaj monitorohet nga Shërbimi Sprovues i Kosovës nëse sjelljet e të liruuarit me kusht janë në përputhje me vendimet e Panelit", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se afërsisht aq sa të burgosur përfitojnë në Shqipëri nga Ligji për Falje, e që janë 570, numër i përafërt (500-600) i drejtohen presidentes së Kosovës

për falje dhe nuk falet asnjë. "Presidentja ka të drejtë t'i falë të gjithë të burgosurit që kërkojnë falje, mund të mos e falë asnjërin sepse e ka këtë të drejtë, mund të marr parasysh rekomandimin e komisionit ad hoc por mund ta injorohet krejtësisht propozimin komisionit ad hoc dhe në asnjë rast nuk konsiderohet si shkelje e ligjit apo përgjegjësi për këtë veprim apo mosveprim. Në anën tjetër me këtë sjellje të presidentes problemet më të mëdha i shkaktojnë Shërbimit Korrektues të Kosovës që punojnë me të burgosurit, që nga dita e pranimit e deri në ditën kur lirohen. Vet refuzimi thuaja i të gjitha kërkesave për falje nga presidenti /presidentja paraqet goditje ndaj SHKK për faktin se i devalvon para të burgosurve dhe ua merr argumentin motivues se me sjellje të mira, të burgosurit do të fitojnë, sidomos nga falja", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Kurti vizitoi familjet e komuniteteve në Pejë, përfituese nga thirrja e MAPL-së për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive

PEJË, 8 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti, bashkë me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë vizituar tri familje përfituese nga thirrja e MAPL-së për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive të komunitet joshumicë në komunën e Pejës. Kryeministri vizitoi familjen pesëanëtarëshe Palmar nga komuniteti boshnjak e cila, siç tha kryeministri, ka pasur shumë nevojë për strehë të qëndrueshme mbi kokë e për banim të dinjitetshëm. Më pas vizitoi familjen Hagjijaj nga radhët e komunitetit rom, e cila, gjithashtu, kishte nevojë për kushte dhe banim të dinjitetshëm. Aty falënderoi familjen Hagjijaj për mikpritjen dhe punëtorët për

punën që kanë bërë. Kurse në fshatin Treboviq vizitoi dhe u takua me shtatë anëtarët e familjes Saku nga komuniteti egjiptian të cilët në muajin dhjetor do të jenë me shtëpi të re. Tre milionë euro ka qenë buxheti i programit për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive të komuniteteve jo shumicë në komunë këtë vit. Në kuadër të tij në proces të përfundimit të ndërtimit janë 57 shtëpi. Krahas tyre punimet janë duke u zhvilluar edhe për renovimin e 230 shtëpive të tjera. Ky program do të vazhdojë edhe me thirrje e dytë vitin tjetër, për të cilën thirrje tashmë është ndarë buxhet në vlerë tre milionë euro.



Qeveria ia jep në shfrytëzim për 15 vjet dy prona komunës së Dragashit

DRAGASH, 8 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për dhënie në shfrytëzim 15 vjet të pronave të kërkuara nga komuna e Dragashit të menaxhuara

nga Agjencia e Pyjeve e Kosovës. Vendimi është marrë në mbledhjen e së mërkurës, me ç'rast kryeministri Albin Kurti ka thënë se kjo kërkesë e

komunës ka për qëllim ndërtimin e deponisë së mbeturinave komunale për nevojat e qytetarëve në fshatin Restelicë. Ndërkaq ministri i Administrimit të

Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, tha se pronat e kërkuara nga komuna e Dragashit janë në dy parcela me sipërfaqe 13 mijë 568 metra.



Konjufca: Kosova edhe pa qenë anëtare e OKB-së ka dhënë zotimin për të kontribuar në përpjekjet e përbashkëta globale

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Krye parlamenti Glauk Konjufca ka marrë pjesë në konferencën për Agjendën Transformuese të Kosovës të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, organizuar nga Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm i Kuvendit dhe mbështetur nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Me këtë rast, Konjufca tha se duke pasur parasysh kohën sfiduese nëpër të cilën po kalon bota, sidomos pas pandemisë Covid-19, më shumë se kurrë merr kuptim thirrja e sekretarit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për domosdoshmërinë e ngritjes së solidaritetit global.

Ai tha se nevojitet solidaritet e bashkëpunim i vendeve të zhvilluara me ato vende që ende janë në faza më të hershme të zhvillimit dhe me ato vende që

sfidohen nga mungesa e elementeve bazike për jetë. "Mendoj se pikërisht ky është qëllimi i Agjendës 2030 të OKB-së. Solidaritet dhe përpjekje e përbashkëta për të nxitur barazi, prosperitet dhe mirëqenie për të gjithë pa dallim. Kosova edhe pa qenë anëtare e OKB-së dhe nënshkruese e Agjendës 2030 ka dhënë zotimin për të kontribuar në përpjekjet e përbashkëta globale për zhvillim të qëndrueshëm. Duke qenë kjo agjendë komplementare e asaj evropiane, jam i bindur se zbatimimi i saj na afron më shumë me këto dy organizma, për ne si shtet aspirues për anëtarësim në to", tha kryetari i Kuvendit.

Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, i formuar nga Kuvendi i Kosovës, shtoi kryetari Konjufca, luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e



zbatimit të kësaj agjende. Sipas kreut të Kuvendit, deri më tani është arritur që të

inkorporohen Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm përbrenda punës së Kuvendit dhe

trupave të tij të punës, duke ndihmuar institucionin të luajë një rol më proaktiv në nxitjen e bashkëpunimit ndërsektorial dhe mbikëqyrjen e institucioneve ekzekutive në zbatimin e këtyre objektivave. "Në këndvështrimin tim Agjenda 2030, duke qenë se është e ndërtuar në formën e një plani zhvillimor për të gjithë sektorët që kërkojnë ndërhyrjen institucionale, e ndihmon Kosovën për ta projektuar më mirë dhe më sigurt të ardhmen", tha Konjufca.

Ai shtoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet që nëpërmjet mekanizmave që ka në dispozicion, të kontribuojë në miratimin e ligjeve dhe politikave që garantojnë barazi dhe gjithëpërfshirje për të gjitha grupet shoqërore, si dhe mbikëqyrjen efektive të zbatimit të tyre.

BEI dhe Komisioni Evropian do ta trefishojnë mbështetjen këshillimore për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Falë marrëveshjes së njoftuar nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI) dhe Komisionit Evropian në takimin e palëve të interesuara të Jaspers, të organizuar në Bruksel, Banka do të jetë në gjendje ta trefishojë ndihmën e saj këshillimore për Ballkanin Perëndimor dhe, mundësisht, edhe Turqinë. Mbështetja do të ofrohet në kuadër të programit të përbashkët të institucioneve Jaspers, duke e çuar buxhetin në vlerën më të madhe deri më sot prej 20 milionë eurosh për asistencë teknike dhe rritjen e kapaciteteve të ekspertëve gjatë gjashtë viteve të ardhshme. "Kjo marrëveshje e re angazhon burime në nivel rekord për ta mbështetur procesin e zgjerimit të BE-së, duke i ndihmuar vendet të përgatitnin strategji, plane dhe investime jetike, duke rritur kapacitetet e tyre për përgatitjen



dhe zbatimin e projekteve. Kjo mbështetje e shtuar këshillimore e BEI-t do t'u lejojë partnerëve tanë në Ballkanin Perëndimor të zbatojnë në mënyrë efektive më shumë projekte në kuadër të planit ekonomik dhe investimeve të BE-së, duke ndjekur prioritetet e politikës së BEI-t", ka pohuar zëvendëspresidentja e BEI-t, Teresa Czerwinska.

Që nga viti 2005 programi këshillimor i BEI-t, Jaspers, është zbatuar në 27 vende dhe ka mbështetur përgatitjen e qindra projekteve me vlerë mbi 317 miliardë euro në fushat e transportit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit, novacionit, kujdesit shëndetësor dhe tranzicionit të gjelbër brenda dhe jashtë BE-së.

Mathieu Bousquet, drejtor i komanduar në Drejtorinë e Përgjithshme për Negociatat e Fqinjësisë dhe të Zgjerimit (DG

NEAR), Komisioni Evropian, ka theksuar se janë shumë të kënaqur për nënshkrimin e një marrëveshje të re kontributi me BEI-n për vazhdimin e mbështetjes këshillimore Jasper në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. "Nëpërmjet Jaspers ne vazhdojmë t'i mbështesim përfituesit e IPA në rrugën e tyre drejt BE-së përmes përgatitjes dhe zbatimit të projekteve infrastrukturore që janë teknikisht të shëndosha, të qëndrueshme për mjedisin, si dhe ekonomikisht e financiarisht të qëndrueshme. Vlen të theksohet se Jaspers gjithashtu këshillon vendet anëtare të BE-së për investime dhe përgatitjen në proceset e mëparshme të anëtarësimit. Jam i bindur se shërbimet këshillimore të ofruara nga Jaspers do të vazhdojnë të sjellin një ndikim pozitiv social dhe përfitime ekonomike për qytetarët", ka theksuar Bousquet.

Malta hap konsullatë në Kosovë, Remzi Ejupi emërohet konsull nderi

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Remzi Ejupi është emëruar Konsull Nderi i Maltës në Kosovë. Emërimi i tij është bërë në Prishtinë nga ambasadorja jorezidente e Maltës në Kosovë, dr. Scerri Ferrante. Për këtë lajm ka njoftuar vetë Ejupi në "Facebook". "Miq të dashur, desha të ndajë me ju lajmin se këto ditë jam emëruar zyrtarisht Konsull Nderi i Maltës në Kosovë, një nder i madh për mua që të angazhohem edhe më shumë në thellimin e bashkëpunimit mes Kosovës dhe Maltës. Për

këtë dua të falënderojë Qeverinë e Maltës, në veçanti Shkëlqesinë e saj, ambasadorën dr. Juliana Scerri Ferrante me të cilën do të punojmë, jo vetëm të ofroj shërbime konsullore që përfshin asistencë për shtetasit maltezë në Kosovë, por do të angazhohemi që të rrisim bashkëpunimin në tregti, ekonomi, kulturë dhe turizëm", ka shkruar ai.

Ejupi ka bërë me dije se me detyrën e re që ka marrë do ta japë maksimumin që t'i hapë dyert për pronarët e

bizneseve dhe ta referojë interesin tregtar me ndihmën e subjekteve, si Oda Ekonomike e Kosovës dhe Shoqatat Tregtare, si STIKK dhe ICK. "Jam i informuar se kompanitë kosovare tashmë kanë marrë pjesë në takimet B2B dhe në forumin e biznesit në Maltë këtë vit, organizuar nga Dhoma e Tregtisë së Maltës, pas propozimeve të Ambasadores së Maltës. Do të punoj shumë për të rritur turizmin ndërmjet Maltës dhe Kosovës, duke iniciuar përpjekje për të



krijuar lidhje më të forta. Fluturimet direkte jo vetëm që do të rrisin turizmin, por edhe

aktivitetet tregtare dhe ekonominë e të dy vendeve", ka shkruar Ejupi.

Takimi i ministrave të Evropës Juglindore, Kosova: Përpjekjet tona për bashkëpunim në bujqësi nuk duhet të pengohen

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë në Takimin e 17-të Vjetor të Punës së Ministrave të Bujqësisë nga Evropa Juglindore (EJL), i cili është mbajtur në Jahorinë të Bosnjë-Hercegovinës.

Në fjalimin para ministrave të tjerë nga rajoni dhe përfaqësuesve nga shtetet e BE-së si dhe komisionarit të BE-së për Bujqësi, ministri Faton Peci ka theksuar se sikur edhe në çdo fushë të qeverisjes, ashtu edhe kur bëhet fjalë për zhvillimin e bujqësisë dhe perspektivat e zhvillimeve të përgjithshme që lidhen me të, bashkëpunimi ndërkombëtar është çelësi i përparimit, thjesht sepse mundëson të mësojnë nga njëri-tjetri si dhe t'i ndajnë përvojat më të suksesshme. "Angazhimi im për të marrë pjesë në takimin e sotëm mund të ndikojë lehtësisht nga banalitetet e pengesave politike. Nevoja për të marrë një vizë për të më mundësuar hyrjen në Bosnjë-Hercegovinë mund të duket jashtë temave për të cilat jemi mbledhur, por kjo tregon qartë se si

bashkëpunimi ynë në sektorin që përfaqësojmë, dëmtohet në heshtje nga mungesa e bashkëpunimit diku tjetër. Ndërsa sa i përket Procesit të Berlinit dhe sfidave në të ardhmen, palët e interesuara të kësaj nisme duhet të kërkojnë sqarime konkrete se pse nuk po zbatohen angazhimet e dakorduara. Besoj se të gjithë jemi dakord që përpjekjet tona për bashkëpunim në bujqësi nuk duhet të pengohen apo ndikohen nga faktorë të tjerë", ka thënë ministri Peci.

Në fjalimin e tij, ministri i BPZHR-së, Peci, theksoi se Qeveria e Kosovës dhe ministria që ai drejton vazhdojnë ta riafirmojnë angazhimin ndaj planeve strategjike të Politikës së Përbashkët Evropiane Bujqësore për ta forcuar qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor. "Në këtë drejtim Strategjia e Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028 ka objektive të qarta transformimin e sektorit agroekonomik dhe atij të zhvillimit rural, bazuar në njohuri dhe standarde moderne në përputhje me praktikën më të mirë evropiane. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit 2022-2026 është gjithashtu një tregues tjetër,



se agenda jonë legislative është në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian", ka thënë ai, duke i informuar pjesëmarrësit se në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës ka identifikuar gjashtë zona kufitare multietnike në të cilat do të jetë zhvillimi rural, veçanërisht zhvillimi i

agroturizmit një prioritet. "Ftova ministrat e katër shteteve në kufi me Kosovën që të investojnë në zhvillimin e agroturizmit në rajonet e tyre kufitare dhe në këtë mënyrë të krijojnë zona me oferta të përbashkëta turistike, përkatësisht të bëjnë projekte të përbashkëta në agroturizëm. Në këtë mënyrë do ta europianizojmë ofertën turistike të fshatrave tona", ka theksuar ministri Peci.

Krahas kësaj, në funksion të temave që potencoi në adresimin e tij, ministri Peci ka zhvilluar diskutime dhe takime bilaterale me përfaqësuesit e Gjermanisë, të Kroacisë, të Shqipërisë dhe të Francës si anëtarin më të ri vëzhgues të SWG-së. Me përfaqësuesit francezë edhe një herë konfirmoi angazhimet për bashkëpunim konkret në fushën e blegtorisë dhe verarisë.

Kurti dhe Rizvanolli vizituan Postën e Kosovës: Po zgjerohet rrjeti i zyrave postare edhe në veri

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kanë vizituar Postën e Kosovës. Ata janë pritur nga kryeshefja ekzekutive e kësaj ndërmarrje, Nora Rraci dhe anëtarët e Bordit Drejtues.

Gjatë takimit u vlerësua se Posta e Kosovës është duke siguruar shërbim postar në çdo lagje të madhe dhe çdo fshat të madh për të siguruar lehtësi të shërbimit dhe po zgjeron rrjetin e zyrave postare edhe në veri të vendit.

Kryeministri Kurti ka theksuar se Qeveria e Kosovës siguron shërbimin postar për të gjithë qytetarët, duke kompensuar shërbimin universal postar në përputhje me Ligjin për Shërbime Postare dhe Rregulloret, dhe se Posta është partnere e qeverisë në



shërbimin "One Stop Shop", që lejon qytetarët t'i kryejnë shërbimet e tyre në qendrat e

Postës për disa institucione pa pasur nevojë të shkojnë drejtpërdrejt në to.

Po ashtu, kryeministri Kurti dhe ministrja Rizvanolli vlerësuan se në platformën eKosova po integrohen

të gjitha shërbimet postare, duke filluar deklarimin e adresës postare, që do t'i japë shtytje të madhe cilësisë së shërbimit.

Rizvanolli ka theksuar mbështetjen që i është dhënë Postës së Kosovës dhe bëri me dije se kjo përkrahje do të vazhdojë edhe më tej, në mënyrë që shërbimet postare të jenë afër çdo qytetari të Republikës së Kosovës.

Kryeshefja ekzekutive dhe Bordi Mbikëqyrës kanë përmendur të arriturat që ka shënuar Posta e Kosovës, si pasurimi i flotës me motoçikleta elektrike, të cilat ua mundësojnë shpërndarjen sa më të shpejtë të dërgesave postare te qytetarët dhe, po ashtu, ofrojnë një transport të pastër ekologjik, promovimin që u bëhet vlerave të Kosovës përmes pullave postare dhe të arritura të tjera.

KEDS-i investon rreth 2 milionë euro në Deçan


DEÇAN, 8 NËNTOR - KEDS-i ka njoftuar se po investon fuqishëm në komunën e Deçanit dhe se kompania ka në implementim e sipër 27 projekte anekënd kësaj komune. Bëhet me dije se pas realizimit të tyre, me rrjet të ri elektrik do të bëhen mbi 10 mijë banorë të asaj ane.

Konkretisht, KEDS-i ka filluar realizimin e projekteve në fshatrat Ratishë, Irzniq, Prokolluk, Glogjan, Shllup, Pobergj dhe Dranoc. "Ky projekt kapital, i cili kap shumë prej afër dy milionë eurosh, bën pjesë në kuadër të planit investiv të KEDS-it dhe pritet të përfundojë përgjatë

periudhës 2024-2025. Parapërgatitjet po bëhen edhe për fillimin e punimeve në fshatrat e tjera të kësaj komune, si në Isniq, në Strellc të Epërm dhe në Strellc të Ulët. Projekti në këto fshatra fillon në pjesën e parë të vitit të ardhshëm", thuhet në njoftimin e KEDS-it.



Roma ra, por a do të bie Perëndimi që njohim sot?



Nga: The ECONOMIST
(titulli origjinal: Rome fell.
Will the modern-day West
follow suit?)
Përkthimi: Telegrafi.com

Deklinizmi [rënia] është sërish në modë. Teksa përkeqësohen marrëdhëniet mes Amerikës dhe Kinës, çdo herë e më i famshëm po bëhet studimi i fillimit të fundit të epokave të hershme të hegemonisë. Po shtohen librat që parashikojnë ngritjen e pandalshme të autokratëve të fortë dhe vdekjen e demokracisë. Flitet shumë për “kurthin e Tukididit”: pashmangshmërinë e përplasjes midis një fuqie në rritje dhe një fuqie ekzistuese, kjo pasi – në shekullin e pestë para Krishtit – Athina e sfidoi Spartën. Libri i vogël provokues – Why Empires Fall [Pse bien perandoritë] nga John Rapley dhe Peter Heather – e përshtat këtë qasje me gërshetime prej një novele. Libri bën krahasime mes Perëndimit të vitit 1999 – në zenitin e besimin ndaj tij – dhe të Romës saktësisht 1600 vjet më

parë, asaj të vitit 399 – disa dekada para rënies së perandorisë.

Pjesa më interesante e rrëfimit ka të bëjë me Romën. Ekonomisti politik John Rapley dhe historiani Peter Heather, e kundërshtojnë analizën e njohur që daton që nga Edward Gibboni për perandorinë në rënien graduale – pothuajse që nga fillimi i saj, nën Augustin. Roma, argumentojnë ata, ishte po aq e fortë sa kurrë më parë në fund të shekullit të pestë pas Krishtit. Perandoria pa dyshim që ishte e gjerë dhe nganjëherë e grisur, por u mbajt në këmbë duke zgjedhur kryesisht të huajt e talentuar, duke ua dhënë pushtetin komandantëve të fortë dhe duke bërë marrëveshje me armiqtë e mundshëm. Megjithatë, brenda një dekade Roma i kishte larguar legjionet e veta nga Britania (autorët këtë tërheqje e quajnë Brexit-i i parë). Më pak se një shekull më vonë, bie perandori i fundit perëndimor, Romul Augustuli.

Çfarë shkoi keq? Libri trajton forcat e huaja që u bënë gjithnjë e

më të vështira për t’u rezistuar. Në periferi të dobësimit të perandorisë, vendësit e fuqishëm nisën të identifikoheshin me gotët, ostrogotët, vizigotët, hunët, vandalët dhe të tjerët. Madje, motra e një perandori u martua me një udhëheqës vizigot (me sa duket vullnetarisht) dhe lindi një djalë me pretendime serioze perandorake. Siç përpqej të shpjegonte Gibboni, 250 vjet më parë, perandoria lindore me qendër në Kostandinopojë, vazhdoi për gati një mijë vjet të tjera. Por, edhe ajo po dobësohej dhe po humbiste vazhdimisht terriore, fillimisht përmes luftërave të kushtueshme kundër Persisë dhe më vonë nga ngritja e Islamit dhe e osmanëve.

Gjatë disa shekujve, Evropa Perëndimore u rimëkëmb, fillimisht nën Karlin e Madh dhe më vonë në mënyrë edhe më spektakolare kur fuqinë e vet e përhap (dhe perandoritë e veta) në pjesën më të madhe të botës së njohur. Pyetja që parashtrajnë autorët është nëse përkundur dominimit të dukshëm – deri në

fund të shekullit XXI – Perëndimi në mënyrë të pashmangshme po shkon në të njëjtin drejtim sikurse Roma në shekullin e pestë. Ata flasin për çështjet e tilla si rritja e barrës së borxhit, shtetet e kushtueshme të mirëqenies, kriza me rënien e prodhimitarisë, rënia demografike dhe imigrimi masiv. Sfidat e mëdha për Perëndimin, ata i shohin nga rritja e Azisë, veçanërisht nga Kina dhe nga India, si dhe nga fuqitë antiperëndimore si Rusia dhe ngritja e Afrikës. Megjithatë, nuk është bindëse analogjia me rënien dhe përmbysjen e Romës. Pjesa tjetër e botës sigurisht që po i afrohet Perëndimit, si ekonomikisht ashtu edhe në aspektin demografik. Ekonomia e Kinës së shpejti mund të jetë më e madhe se ajo e Amerikës. Evropa përbënte një të katërtën e popullsisë globale në vitin 1914, por sot ka më pak se një të dhjetën. Emigracioni, veçanërisht nga Afrika dhe nga Amerika Latine, paraqet një test politik. Populizmi po marshon.

Gjithsesi, në shkallë globale është e vështirë të parashikohet rivali serioz ushtarak me ndikimin që kanë Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj evropianë. Rusia është revanshiste në Ukrainë, por është gjithashtu në një rënie afatgjate. Kina është e brishtë dhe rritja e saj ndjeshëm po ngadalësohet. India është politikisht e pangopur. Është shumë i fuqishëm kontrolli i Perëndimit ndaj teknologjisë dhe ndaj hulumtimit. Dhe, megjithëse perspektivat ekonomike të Evropës mund të jenë të turbullta, produktiviteti amerikan i lë në pluhur shumicën e konkurrentëve. Deklinistët pëlqejnë të citojnë George Bernard Shawin, thënia e të cilit – mbi procesin kalimtar të fuqive të mëdha – shkaktoi një shaka në një fshat anglez: “Roma ra. Babilonia ra. Do të vijë radha e Hajnd’hedit”. Është joshëse të mendosh në këtë mënyrë. Por, për momentin, të paktën nuk është e qartë se kur, nëse ndonjëherë, Perëndimi do ta ndjekë shembullin e Romës. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Spektakël hendbolli sonte në Rahovec

RAHOVEC, 8 NËNTOR - Spektakël i hendbollit premtohet të jetë ndeshja në mes të Rahovecit dhe Besa Famgasit. Kjo ndeshje luhet të enjten prej orës 19:00 në palestrenë "Mizahir Isma" në Rahovec. Numri i shikuesve pritet të jetë i madh, ndërsa nuk do të mungojë loja e fortë dhe

atraktive nga fillimi e deri në fund. Rahoveci - Besa Famgas është ndeshje e mbetur e xhiros së katërt të Superligës së Kosovës në hendboll. Ndeshja ishte shtyrë për shkak të angazhimeve të skuadrës pejane në gara evropiane. Besa Famgas është kampione në fuqi dhe pretendente e

vazhdueshme për trofe. Por këtë edicion titullin e kampionit e kërkon edhe Rahoveci, që ka bërë ndryshime të mëdha në përbërje, duke u forcuar shumë. Rahoveci është ngritur vazhdimisht në vitet e fundit dhe këtë synon ta dëshmojë ndaj skuadrës më të mirë të

dekadave të fundit në hendbollin e Kosovës. Asnjëra skuadër nuk ka pësuar humbje deri më tani. Rahoveci ka pesë fitore, ndërsa Besa Famgas ka fituar katër ndeshjet e deritashme. Superderbi pritet të japë sinjale për forcën e vërtetë të dy skuadrave në këtë edicion.



Besa, po ashtu, ka bërë ndryshime të mëdha, ndërsa tashmë ka fituar Superkupën e Kosovës.

Ballkani kërkon 'hakmarrje' ndaj Astanës

Kampionët e Kosovës synojnë t'i marrin tri pikët e plota nga përballja me Astanan në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. "Nuk mund të jap përqindje se kush do ta fitoj ndeshjen, sepse futbollit nuk është shkencë ekzakte. I kam përgatitur djemtë e mi të fitojnë", ka deklaruar Ilir Daja, trajner i Ballkanit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Klubi kampion i Kosovës, Ballkani, sot (e enjte) e zhvillon ndeshjen e katërt në kuadër të fazës së grupeve në Ligën e Konferencës. Klubi nga Suhareka është mysafir i Astanës dhe për këtë ndeshje është përgatitur maksimalisht me synimin për të arritur fitore, njëherësh për t'iu "hakmarrë" për humbjen që ky klub ia shkaktoi në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" me rezultat 1-2. Të mërkurën në konferencë për medie, trajneri Ilir ka thënë se skuadrën që ai e drejton e pret një ndeshje e vështirë, por se i ka përgatitur djelmohat për të arritur fitore. "Fusha artificiale nuk do të

jetë problem, pasi edhe ne kemi fushë të tillë. Çka kanë përparësi është se do t'i kenë tifozët, por ne do të shfrytëzojmë atë sikur të ishin duke përkrahur skuadrën tonë. Do të na pëlqente të fitonim, por është një ndeshje e vështirë edhe në aspektin taktik dhe fizik. Nuk mund të jap përqindje se kush do ta fitoj ndeshjen, sepse futbollit nuk është shkencë ekzakte. Unë kam përgatitur djemtë e mi të fitojnë. Nëse e marrim përvojën, Astana ka më shumë, pasi ka marrë pjesë në Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës", ka thënë Daja. Krahas trajnerit Daja në konferencë i pranishëm ishte edhe mbrojtësi Arbër Potoku. Ky i fundit ka thënë se Astana ndeshjen e parë e fitoi në dy rastet që kishte të cilat i shfrytëzoi. Ai beson se Ballkani



mund ta kalojë fazën e grupeve. "Në ndeshjen e parë pritshmëritë kanë qenë më të mëdha. Astana është klub i madh, por fati në atë s'ka qenë me ne. Astana fitoi me dy goditje. Ky është futbollit. Për ne është viti i dytë. Sigurisht se objektivi ynë nuk ka qenë ta kalojmë grupin, por pas rezultateve, pritshmëritë janë rritur. Tani e dimë siç jemi në tabelë, kemi shanse ta kalojmë

grupin dhe do të bëjmë gjithçka të arrijmë këtë objektivi madhor", ka deklaruar Potoku. Një ditë para ndeshjes edhe Klubi i Ballkanit ka reaguar në faqen zyrtare duke shprehur krenarinë për përkrahjen që ka marrë klubi në Kazakistan ku jetojnë dhe veprojnë shumë shqiptarë. "Ne jemi të lumtur që qindra shqiptarë që jetojnë e veprojnë në Kazakistan do të jenë

në tribuna për ta përkrahur kampionin e Kosovës. Na priftë e mbara!", thuhet në reagimin e klubit suharekas. Ndeshja në mes të Astanës dhe Ballkanit zhvillohet në "Astana Stadium" nga ora 16:30. Në Grupin C, Viktoria Plzen është në vendin e parë me 9 pikë, kurse Dinamo Zagrebi, Ballkani dhe Astana kanë nga 3 pikë.

Prokuroria hedh poshtë kallëzimin penal kundër Agim Ademit

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Prokuroria Themelore e Prishtinës ka hedhur poshtë kallëzimin penal ndaj kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, i dyshuar për veprat penale të shmangies nga tatimi dhe keqpërdorimit të besimit, ka njoftuar zëdhënësjja e kësaj prokurorie, Laureta Ulaj. Ndaj Ademit kishte parashtruar kallëzim penale Njësia Rajonale e Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në



Prishtinë nën dyshimet se ai ka kryer veprat penale "Shmangie nga tatimi" dhe "Keqpërdorim i besimit", shkruan "Betimi për Drejtësi". Mirëpo, prokurori i rastit, Ali Hajdini, ka nxjerrë aktvendim për hedhje poshtë të këtij kallëzimi penal me arsyetimin se pas analizimit të natyrës, rrethanave të rastit dhe karakterit të veprës penale çështja duhet të zgjidhet përmes pezullimit të përkohshëm të procedurës. "Prokurori ka shqyrtuar dhe

analizuar në tërësi shkresat e lëndës dhe duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe karakterin e veprës penale dhe të kryerësve dhe zotimit e të dyshuarve se di t'i përmushin detyrimet, ka vlerësuar se lënda plotëson kushtet që të zgjidhet përmes Procedurës Alternative, përkatësisht të bëhet Pezullimi i Përkohshëm i Procedurës në kuptim të nenit 227 të KPP-së", thuhet në aktvendimin për hedhje të kallëzimit penal.

Ramadani: Po bisedoj me Interin

LECCE, 8 NËNTOR - Mesfushori i Lecces dhe Kombëtares së Shqipërisë, Ylber Ramadani, ka konfirmuar se ka zhvilluar bisedime me drejtorin e Interit, Piero Ausilio. Ish-futbollisti i Ferizajt ka bërë me dije se është ëndërr e tij që të

veshë fanellën e Interit. 27-vjeçari mbërriti në skuadrën e Lecces këtë verë nga Aberdeen në një marrëveshje me vlerë vetëm 1.2 milion euro. Ai nënshkroi një kontratë trevjeçare me një opsion për të katërtin. "Ai ishte në Tiranë,

takova Ausilion dhe qëndruam gjatë duke biseduar. Për mua është një motiv shumë i madh. Nuk mund të ndaloj së punuari për të shkuar tek Interi", ka thënë Ramadani. Mesfushori shqiptar 27-vjeçar foli më pas për idenë për të

luajtur me bashkatdhetarin e tij Kristjan Asllani. "Unë përshtatem shumë shpejt. Asllani është më teknik se unë, por unë bëj gjëra të tjera. Mund të luaj me një ose dy mesfushorë qendrorë", ka shtuar Ramadani.



Rooney bën rrëfimin shokues: Pija alkool derisa më binte të fikët

MANCHESTER, 8 NËNTOR - Wayne Rooney ka bërë një rrëfim shokues në një podcast të organizuar nga Rob Burrow, një ish-lojtar i ragby. Legjenda angleze ka zbuluar se që në fillim të karrierës kishte probleme me faktin se ishte i famshëm. "Në një moment u tërhoqa në vetvete, u mbylla

në shtëpi për disa ditë. Kur isha në të 20-at e mia, alkooli më relaksonte, pija derisa më binte të fikët", bëri me dije trajneri i ri i Birminghamit. Rooney hyri në futbollin profesionist në moshën 16-vjeçare si lojtar i Evertonit, u bë anëtar i kombëtares së Anglisë në moshën 17-vjeçare dhe u

transferua në Manchester United në moshën 18-vjeçare. Në United ai u bë golashënuesi më i mirë në historinë e klubit. "Unë nuk shoqërohesha shumë me njerëz të tjerë në atë kohë. Më vinte turp. Më dukej sikur i zhgënjeva të gjithë rreth meje. Nuk dija si ta përballoja", ka vazhduar

Rooney me rrëfimin e tij. "Nëse nuk e pranon ndihmën dhe këshilla të të tjerëve, shumë lehtë e gjen veten në një situatë ku arrini fundin. Kështu më ndodhi mua në ato pak vite. Për fat të mirë sot nuk kam më frikë të flas për problemet që më shqetësojnë", ka përfunduar Rooney.



Marku: Josh Taylor nuk mund ta përballojë fuqinë time

TIRANË, 8 NËNTOR - Boksieri shqiptar Florian Marku (13 fitore, 1 barazim) ka dhënë një intervistë për "Sky Sports Boxing". Ai është zotuar se do të bëhet njeriu i parë që do ta mund me KO boksierin Josh Taylor (19 fitore, 1 humbje), teksa bën thirrje për një luftë me ish-kampionin e padiskutuëshëm në peshën super të lehtë. Taylori ka humbur vetëm një herë (në duelin e fundit, me vendim unanim) në një karrierë jashtëzakonisht të suksesshme, që e ka parë atë të bashkojë të katër titujt kryesorë në peshën "welter" dhe të përballtet me luftëtarët më të mirë në botë në peshë. Gjithsesi, Marku po këmbëngul për t'u ndeshur me Taylorin dhe ka deklaruar se do ta ndalonte skocezin. "Kështu ndihem dhe e di. Josh është me të vërtetë me përvojë, teknik, por fuqia e tij nuk përputhet me fuqinë time", ka thënë Marku për "Sky Sports". "Fuqia ime do ta dominojë atë. Unë do ta shtyj atë dhe do ta ndaloj. Ai nuk mund ta përballojë fuqinë time për 12 raunde apo për 10 raunde. Josh Taylor nuk është mundur kurrë me KO, pasi nuk ka qenë kurrë në ring me dikë si unë", ka deklaruar boksieri shqiptar. "Dëshira ime është shumë më e madhe. Ai nuk ka asgjë më shumë për të provuar. Unë jam duke u



ngjitur në mal, ndërsa ai arriti në majë të malit. Unë jam i uritur për të arritur atje. Kur ai të jetë në ring me mua do të shkoj ta ndiej forcën time. Kjo është arsyeja pse unë dua këtë lloj lufte të madhe", u shpreh Florian Marku. Promotori i Markut, Ben Shalom, është në negociatë për ta organizuar sfidën. "Ne jemi në bisedime me Top Rank dhe e di që një ofertë i është bërë Josh Taylor. Është një luftë fantastike mes dy personazheve të mëdhenj. Çfarë atmosfere do të ishte në Glasgow", ka thënë Ben Shalom. Për ta bërë atë të ndodhë, Marku është i gatshëm të bjerë nga pesha

dhe të duelojë në një peshë më të ulët. "Ne mund të bëjmë një peshë tjetër, mund të duelojmë në peshën e tij nëse Josh Taylor nuk dëshiron ta provojë veten në peshën 'welter'. I besoj vetes 100 për qind", ka shtuar Marku. "E dua këtë duel për t'u treguar njerëzve se nuk jam vetëm me fjalë. Kur të jem në ring me këta emra të mëdhenj do t'ua lehtësoj punën. Kam besim të plotë te vetja. Është koha për t'u treguar njerëzve se çfarë mund të bëj në botën e boksit. Në letër, Taylori është favoriti, unë jam i dobët, por shpresoj se ai do ta pranojë këtë luftë", ka pohuar Marku.

Verstappeni: Në Las Vegas do të shkojmë për 'show'

LAS VEGAS, 8 NËNTOR - Pas tri garash radhazi, Formula 1 këtë fundjavë është pushim. Gara e radhës do të jetë pas 10 ditësh në Las Vegas, një pistë qytetase që rikthehet në kalendarin pas 40 vjetësh. Njëvendëshet e Formulës 1 do të garojnë në rrugët e Las Vegasit, në një garë me drita që parashikohet të jetë spektakolare. Pista do të jetë e gjatë 6 201 metra, kryesisht me pjesë të drejta të gjata, të ndërprera nga kthesa të avashta. Në prag të kësaj gare ka folur Max Verstappen, kampion i botës në fuqi. "Para së gjithash, aty do të



shkojmë më shumë për spektaklin sesa për vetë garën", ka deklaruar holandezi i Red Bull Racing. "Jam mjaft kurioz për këtë garë dhe këtë pistë edhe pse duket se do të shkojmë aty për të luajtur kazino e më pas do të

largohemi, siç bëjnë të gjithë ata që shkojnë në Las Vegas. Pista duket e thjeshtë dhe e lehtë për t'u mësuar edhe pse ka disa kthesa që duhen pilotuar me kujdes", ka thënë Verstappen. "Mendoj se do të jetë një garë me shumë parakalime, pasi ka disa vende ku mund të kryhen ato. Të shohim se si do të jetë asfalti dhe si do të përshtaten makinat e gomat aty. Pjesët e drejta janë të gjata dhe të lehta për ta arritur njëri-tjetrin e për të parakaluar. Të shohim", u shpreh Verstappen.

SHKURT

Jeremy Harris largohet nga KB Bashkimi

KB Bashkimi ka njoftuar largimin e fundorit amerikan Heremy Harris. Në një njoftim në rrjetin social "Facebook", ka treguar se me marrëveshje të dyanshme ka shkëputur kontratën e basketbollistit. "KB Bashkimi bën të ditur se me marrëveshje të dyanshme ka shkëputur kontratën me lojtarin Jeremy Harris, të cilin e falënderojmë për kontributin e dhënë dhe i dëshirojmë suksese në karrierë", thuhet në njoftim e klubit prizrenas.

Lojtari më i mirë në La Liga 2, Uzuni: Puna ime sapo ka filluar

Myrto Uzuni është shpërblyer me çmimin e lojtarit më të mirë të La Liga 2 për sezonin 2022/2023. Ylli kuqezi ishte një bomber i vërtetë për ekipin e Granadas, pasi realizoi 23 gola dhe e ndihmoi skuadrën të ngrihej në La Liga, divizionin e parë të Spanjës. Me një postim në rrjetet sociale, sulmuesi i kombëtares shqiptare u shpreh shumë i lumtur dhe ka theksuar se rrugëtimi i tij sapo ka nisur. "Shumë i emocionuar për të ndarë këtë arritje me të gjithë ju! Të emërohem lojtari më i mirë në La Liga 2 në Spanjë është nder i madh për mua. Të jesh golashënuesi më i mirë dhe të ngjitesh në La Liga ishte një ëndërr e realizuar. Tani është koha të punoj shumë dhe të jap maksimumin tim për ta mbajtur këtë ekip aty ku e meriton të jetë, ndër më të mirët në Spanjë. Faleminderit tifozëve të Granadës! Ju jeni kyç në motivimin tim, shokët e skuadrës, trajnerët dhe familjen time për mbështetjen tuaj të palëkundur. Nuk mbaron këtu. Sapo kemi filluar", ka thënë Uzuni.

Diniz: Mungesa e Neymarit është humbje për futbollin

Neymari është operuar dhe pritet të jetë jashtë fushës së gjelbër për një kohë të gjatë. Trajneri i Kombëtares së Brazilit, Fernando Diniz, ka thënë se është një mungesë e madhe mosprania e Neymarit jo vetëm për futbollin brazilian, por për futbollin në tërësi. "Mungesa e Neymarit është gjithmonë një goditje e rëndë. Është një humbje për futbollin brazilian dhe për futbollin në tërësi. Ai është një gjeni futbollit, një nga lojtarët më të mirë në histori, ky është mendimi im", ka thënë Diniz. "I urojmë shërim të shpejtë dhe të kthehet më i fortë. Mendoj se ende nuk i ka shkruar faqet më të mira në historinë e tij. Ky dëmtim nuk e fshiu atë mundësi, mund ta ketë vështirësuar, por do të mund ta transformojë në forcë për t'u rikthyer më i fortë", ka shtuar Diniz.

Pioli: Gjithnjë dua ta shoh këtë Milan

AC Milan ka arritur një fitore shumë të rëndësishme ndaj PSG-së në Ligën e Kampionëve me rezultat 2-1. Ky trepikësh rikthen qetësinë në shtëpinë e "djallit", por Pioli kërkon të ketë vazhdimësi të fitoreve. "Është e qartë që dëshiroj të shoh gjithnjë këtë Milan. Këto ndeshje tregojnë shumë gjëra. Vuajtëm, ata kishin kontrollin e topit, por ne kishim raste edhe për të shënuar ndonjë gol më shumë. Kemi bërë një hap të rëndësishëm përpara, por ky grup do të vendoset në ndeshjen e fundit", ka thënë Pioli. "Tani kemi ndeshjen direkte me Dortmundin që është përpara nesh me pikë. Mund të jetë përcaktuese. Leao? Ky duhet të jetë standardi i tij. Mund të jetë një kampion, por kjo varet vetëm nga ai. Bëri një ndeshje të shkëlqyer ashtu si të gjithë", ka shtuar Pioli.

Xavi pas humbjes nga Shakhtari: Jemi në një çast të keq

Në Ligën e Kampionëve, Barcelona pësoi humbje nga Shakhtar Donetsk me rezultat 1-0. Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë se klubi i tij është në një çast të keq dhe

kjo është më shumë çështje mendore. "Jemi në një çast të keq. Është një çështje mendore. Jemi të bllokuar. E humbëm shumë topin, nuk sulmuam mirë, nuk e

mbrojtëm mirë atë qendër anësore dhe gabimet janë të kushtueshme", ka thënë Xavi. Ai e ka vlerësuar si një nga ndeshjet më të këqija prej se është në krye të Barcelonës. "Në

pjesën e dytë u përmirësua, ishte e mirë, por e pamjaftueshme. Është turp sepse donim të vërtetonim vendin tonë në 1/8. Nuk e kam problem ta pranoj, duhet të

jemi autokritikë dhe të sinqertë. Meritua të humbim. Kjo është një nga ndeshjet më të këqija që kemi luajtur që kur erdha te Barça dy sezone më parë", ka deklaruar Xavi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 1221/1
 Datë: 08.11.2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Ligjit nr. 06/L -113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, nxjerr:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e datës 20 shtator 2023, me nr. 989/1, për pozitat Drejtor i Qendrës së Kompetencës, Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe dy Zëvendës Drejtor në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, se ky konkurs ANULOHE.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë çështjen e procedurave të zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës për drejtor dhe zv .drejtor në Institucione Edukativo Arsimore dhe Aftësuese, duke marr për bazë dinamikën dhe volumin e punës, si dhe për të qenë në përpikëri me procedurat ligjore konkursi i datës 20 shtator 2023, me nr. 989/1, anulohet.

Konkursi për pozitat Drejtor i Qendrës së Kompetencës, Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe dy Zëvendës Drejtor në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, sipas procedurave ligjore do të rishpallen. Kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e dt.20 shtator 2023, nëse shprehin interesim për aplikim duhet të dorëzojnë vetëm aplikacionin e plotësuar, ndërsa dosja së bashku me dëshmitë e bashkangjitura nga konkursi paraprak do ju bashkëngjitet aplikacionit nga ana e Burimeve Njerëzore të AAAPARr-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 09.11.2023
 010/2023

Referenca: AAPSK –

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Mercedes ML 270CDI ngjyre hiri,dizel,viti i prodhimit 2001,me targa vendore	1 copë	3,000.00€		
2	Peugeot 406 ngjyrë e kaltër. benzin,viti i prodhimit 1999, me targa vendore	1 copë	800.00€		
3	Opel Astra ngjyre e bardhe, dizel,viti i prodhimit 1992-per skrap	1 copë/ për skrap	246.10€		
4	Passat 35I, ngjyre e hiri metalike, dizel,viti i prodhimit 1988-per skrap	1 copë/ Për skrap	280.60€		
5	VW Golf II-19E, ngjyre e bardhë, benzin, viti i prodhimit 1989-per skrap	1 copë/ për skrap	211.60€		
6	Smart , ngjyre Zeze, ngjyre zeze metalike,benzin, viti i prodhimit 1999 -per skrap	1 copë/ për skrap	158.00€		
7	VW Golf II,ngjyre e kuqe,benzin,viti i prodhimit 1989,me targa vendore	1 copë/ për skrap	300.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 16.11.2023 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bajturi (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 16.11.2023, prej orës 10:00-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.**

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: <https://aaprk.rks-gov.net/> ose ne web faqen e MD-së <https://md.rks-gov.net> në linkun e AAPSK-së <https://aaprk.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00 Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

Lumë's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumescdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Biznesi "HAVOLLI DEKOR" SH.P.K. ne numër unik: 811548611, njofton opinionin për uljen e vlerës së kapitalit të biznesit nga 10,000 euro ne vlerën 1,000 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- LejlaQuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. 6 deri të 9.
- MiftarQuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "PrenkJakova".
- Fadil Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. të Gjimnazit "Hajdar Dushi".
- Tylaj Krasniqi B.I ALMAS, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811365734.
- JasharIstrefi, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "MEHË UKA", ish shkolla "QAZIM BAJGORA".
- LutfijeTahiri, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "TREPÇA".
- Valton Gashi nga Rogova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Haxhi Hoti" Rogovë.
- Mentor Thaci shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.
- Djellza Islami nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi".
- Shkëndije Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplmën e shkollës së mesme "Milladin Popoviq".
- Evelina Huma nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Kadri Kusari".
- Berat Myrta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

